



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 08

Datë: 28. 02. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Selmani, drejtoreshë, ud e ZRPP.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Raport i Këshillave të KQZ-së:
 - Këshilli për Operacione Zgjedhore:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Softuerin e Rezultateve.
 - Këshilli për Buxhet dhe Financa:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve për zgjedhjet lokale 2021.
 - Shqyrtimi i buxhetit për pagesën e obligimeve të pagesave për anëtarët e KVV-ve të cilët nuk janë paguar.

- Këshilli për Personel:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të panelit intervistues për pozitën e zv. Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së dhe Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së.

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Ju përshëndes të gjithëve, e hapi mbledhjen e KQZ-së. Agjendën e mbledhjes e keni para vetës...! Gjithashtu, e kemi procesverbalin nr. 7 të mbledhjes së KQZ-së. A ka dikush diçka, ndonjë vërejtje sugjerim...?

Gordana Llaban: Këshilli për personel nuk është takuar, nuk ka mbajtur mbledhje nuk e di pse është kjo pikë e rendit të ditës ! Nuk kemi ndonjë rekomandim. Gjithashtu, nga z. Ilir Gashi, tha se lidhur me pikën te Personeli, është dashur me pas personeli takim në mënyrë që të vijë me këtë pikë. Nuk mundet me ardhur direkt, dhe është mirë me e kthye përsëri në personel, dhe me ardhur si rekomandim...

Kreshnik Radoniqi: Edhe ashtu, është veç një pikë në agjendë por nuk ka asgjë tjetër...

Alim Rama: Këshillat është dashur mu takuar dhe me i rekomandua në agjendën...

Kreshnik Radoniqi: Sa di unë, jemi kanë dakorduar që kjo mbledhje me pas vetëm një pinë, atë për specifikat e Souftverit... Te Personeli, hiqet kjo pikë, mbetet vetëm i këshillit për buxhet...

Pas këtyre shpjegimeve, në fakt korrigjimeve të agjendës së mbledhjes, me nëntë vota për miratohet rendi i ditës.

Kreshnik Radoniqi: U miratua rendi i ditës me tetë vota. E kemi në radhë shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit nga mbledhja nr. 7/2022 të KQZ-së. Kush është për miratim...?

Miratohet...

2. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Softuerin e Rezultateve:

Arianit Elshani: KOZ-i, ka shqyrtuar dhe analizuar në mbledhjen e tij specifikat për Softuerin e Rezultateve. Ne, mbetemi në modulet për specifikat e këtilla, mirëpo do t'ishte i rëndësishëm çdo sugjerim, koment lidhur me këto specifika dhe që ka lidhje me souftverin. Sepse, kjo është e rëndësishme për proceset zgjedhore, për vëzhguesit ndërkombëtarë dhe lokal, sepse kjo është në favor të integritetit dhe digjitalizimit të procesit, verifikimeve, skenimit të listave votuese etj. Pra, gjithçka të jetë e integruar, numërimi, tabelimi i rezultateve në mënyrë sa më progresive, dhe që në kohë reale qytetarët t'i kenë rezultatet e votimit të tyre. Pra, të kemi një sistem me databazë të automatizuar...Kjo, do ta lehtësoj shumë procesin s'i në aspekt të rezultateve, dhe të të dhënave tjera në mënyrë automatike...

Por, kjo do t'u ndihmojë jo vetëm votuesve por edhe faktorëve të tjerë, partive politike dhe se, në mënyrë të lehtë, transparente dhe të saktë ta zhvillojmë procesin...Shpresojmë, tha z. Elshani që deri në dhjetorë ta kemi Softuerin, kjo duke e falënderuar edhe OSBE-në për përkrahjen e dhënë në këtë aspekt të digjitalizimit të procesit përmes souftverit...

Kërkojmë, miratimin tuaj...

Sami Kurteshi: Një shpjegim: unë, kam vështirë me e kuptuar, sepse edhe gjuha është e këtillë sepse, janë njerëz profesional. Si për shembull "IFES". Pra, cila është kjo organizatë...! E dyta, besoj që souftveri e ka sistemin e lënies së çdo gjurme. Po ashtu, edhe çështja e regjistrimit të votuesve...! Besoj se krejt ky sistem, gjithçka kush punon, unë besoj se mbetet ajo histori aty. Pra, përmes sistemit gjithçka mund të verifikohet, t'i ndajë gjërat, votuesit nëse janë të Kosovës apo jashtë Kosovës, votat a kanë a janë të brendshme apo kanë ardhur me postë...? Pra, këto desha ti dijë, pra përmes souftverit verifikimet janë më të lehta, të sakta..! Lista votuese, pra përmes sistemit të suftverit në mënyrë automatike ndahen votuesit, dhe tash mendoj se të gjitha specifikat për të cilat në të kaluarën kemi pasur probleme, ne nuk i kemi më tutje, tash ky sistem është ndryshe, i eliminon... Pra, edhe qasjet tona do t'i kemi si KQZ, vëzhguesit, detyrat që do t'i kemi dhe të gjithë ata që do kenë qasje në proces, saktë do të dihen rolet e tyre...

Z. Kurteshi, pyeti se a do të kemi mundësi që të ndryshojmë diçka, apo këto specifika nuk mund të zëvendësohen...? Ai, diskutoi edhe lidhur me shpjegimet e tjera të nevojshme për specifikat, aspektet teknike, qartësimet gjuhësore, azhurnimin e të dhënave etj. Ky, është versioni që ne do ta votojmë, tha z. Kurteshi, në kontekst të vërejtjeve, shpjegimeve dhe sugjerimeve të tij...

Ai shtroi pyetje nëse, personeli teknik ka ndonjë rezervë mbi këto specifika ? Në fund, z. Kurteshi tha se, ky softuer mundëson digjitalizimin e procesit, dhe se “kam bindjen që do ta lehtësoj shumë procesin, për aq sa ne e kuptojmë...”! Por, ishte dashur të jenë këtu edhe personeli teknik të na i shpjegojë disa gjëra, cilat janë rreziqet eventuale, problemet ligjore etj., tha Kurteshi. Ky sistem, pavarësisht se është i komplikuar, nëse vetëm 10% e lehtëson procesin në vitet e ardhshme, është sukses...

Pra, e mira është të startojmë me këtë projekt, dhe e përkrahi sepse dokument sepse edhe është ndërtuar nga ekspertët...Është një dokument shumë i mirë, pavarësisht se teknologjia ka edhe rreziqet e veta...

Arianit Elshani: U ngritën dy çështje, ajo e historiatit dhe e gjurmëve sepse, ajo që zhvillohet në kuadër të këtij softueri, është shumë e rëndësishme për ne që të ketë siguri, transparencë etj. Për shembull, është një modul që në momentin që kandidatët certifikohen, më nuk është si më herët sepse subjektet politike e kanë sifiduar procesin, qoftë duke sjellë një letër shtesë, duke ndryshuar ndonjë kandidatë etj. Mirëpo, përmes souftverit kjo më nuk do të bëhet, dhe kandidatët e cilit do proces zgjedhorë, kur sillen në KQZ më të mos mund të ndryshohen...E dyta, çështja e listës votuese, në mënyrë automatike souftveri do të bëjë ndarjen: votuesit brenda vendit, votuesit jashtë vendit do të jenë të ndarë, dhe këto specifika janë në souftverë...

Sami Kurteshi: Cila është qasja e anëtarëve të KQZ-së në souftver...?

Arianit Elshani: Janë të specifikuara edhe rolet, duke përfshirë rolet e vëzhguesve sepse edhe ata do të kenë privilegjet se çka do të shohin dhe me çka mund të jenë të informuar në proces, por duhet të kemi edhe rregulla sepse, paraprakisht ne duhet të dimë rolin e secilit dhe pastaj, mund ti definojmë edhe qasjet – akseset në të dhëna...

Kreshnik Radoniqi: Në kuadër të përvojës, ndoshta paraqitet nevoja për ndonjë ndryshim. A ka me pas nevojë në specifika për ndonjë ndryshim...?

Alim Rama: Të gjitha specifikat thirren në planet dhe procedurat operacionale zgjedhore, por do të ketë nevojë për ndonjë ndryshim, për shembull, fq. 30, pika 9.7... Ja, kjo të rregullohet, të qartësohet...dhe një korrigjim te pika 10.2.. prapë, duhet një korrigjim...

Sami Kurteshi: Këtu, kemi ekspertët janë. A keni ju ndonjë dyshim që ne mund të kemi, ndonjë rezervë...

Alim Rama: Unë, mendoj që ky souftver ia mundëson KQZ-së digjitalizimin e procesit zgjedhor, e lehtëson, është një proces i integruar...

Illir Gashi: Mendoj që, për detaje do duhej me qenë këtu drejtori i IT-së...

Fazli Stollaj: Ky është një dokument që synon me e dizajnuar atë që ne duam, dhe kjo është me e menaxhue në mënyrë elektronike procesin zgjedhor. Duhet me pas ndoshta hapësira që nuk janë paraparë, por ne kemi punuar dhe kemi shqyrtuar gjitha mundësitë. Përdorimi i teknologjisë, është se kjo tash është e rëndësishme, e sigurisht mund të ketë ndryshime...Por, paralelisht nuk duhet ta lëmë anash as aspektin manuel, sepse teknologjia mund të bie, të bllokohet procesi...

Lidhur me këtë pikë, diskutuan më tej, Burim Ahmetaj, Kreshnik Radoniqi, që kërkoi siguri rreth të dhënave personale, rreth futja e rezultateve etj.

Lidhur me këtë, Alim Rama, tha se, të dhënat duhet të jenë të përputhshme nga futja e dyfishtë që të jen të sakta, dhe kjo e krijon sigurinë në proces...

Čemailj Kurtiši: Unë, vetëm falënderoj për këtë proces. Secili proces i ri, mund ti ketë sfidat por unë e mendoj që ky është një zhvillim i madh, revolucionar do të thosha. Kjo që u diskutua deri më tani, sidomos te siguria e të dhënave etj., por unë falënderoj të gjithë, edhe OSBE-në posaçërisht, sepse janë edhe ekspertët, personat e autorizuar dhe mendoj që procesi do të jetë shumë më i lehtësuar, dhe unë do ta votoj...

Gjithashtu, më tej diskutuan edhe: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alim Rama, qoftë duke shtruar pyetje dhe qoftë duke dhënë shpjegime...

Lidhur me specifikat e Souftverit, mënyrën e hartimit të specifikave, strukturën e tyre, mënyrën e funksionimit, detabazën, përparësitë dhe të metat etj., folën në detaje përfaqësuesit e OSBE-së prezentë, z. Bujar Basha dhe Gazmend Gjonbalaj, meqë OSBE ka dhënë kontributin strategjik në specifikat dhe hartimin e këtij dokumenti.

Në fund, kryetari Kreshnik Radoniqi e hodhi në votim dokumentin e Suftverit.

Kreshnik Radoniqi: Me nëntë vota për, u miratuan specifikat e Softuerit për Rezultatet.

Të ndryshme !

Burim Ahmetaj, në të ndryshme e informoi KQZ-në se, Sekretariati është duke punuar në procedimin e pagesave të trupave zgjedhore, atyre pagesave të mbetura të zgjedhjeve lokale. Ne kemi shqyrtuar mundësitë, dhe bashkërisht kemi ardhur në përfundim që pagesat t'i bëjmë nga pjesa e buxhetit të Sekretariatit. Mund të kemi ndonjë shkelje, mirëpo do ti marrim mjetet nga kategori të sekretariatit, pra do ti marrim nga programi i sekretariatit... Nga trezori, na kanë thënë se mund ta bëjmë këtë... Por, edhe në bashkëpunim me revizorin, në njëfarë mënyre na kanë thënë se mund ta bëjmë. Ne, të gjithë e dimë se kur e kemi përgatitur buxhetin për vitin 2022, nuk kemi llogaritur se do të mbesin këto pagesa, dhe në obligim janë rreth 40 000 euro...

Illir Gashi tha se, nuk e di se pse po nguteni, mirë është një çështje që ka ngecur por në prill ne kemi të drejtë t'i bëjmë pagesat pa bërë ndonjë shkelje. Ndoshta, mirë është që t'i njoftojmë ata që duhet të paguhen se sa, të bëjmë ndonjë shkelje. Askush të mos përballet me ndonjë vërejtje, ose edhe me ndonjë pasojë juridike, shkelje.

Unë jam për por, për 30 ditë nuk kisha thënë...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Kreshnik Radoniqi, Alim Rama dhe Miradije Meha – DAP.

Për KQZ

Kryetari, z. Kreshnik Radoniqi
